

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 25.02.2022*

25.02.2022

Ora 17:41

RENDI I DITËS

Projektakti “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan, me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Nadire Refat Cullhaj (Shkëmbi)”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z.Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y.Merkaj, M.Koja, E. Allushi

• **Parti Politike:**

S’ka

Z. I. Celibashi: Në seancën e sotme kemi në rend dite këto çështje:

projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan”;

projektvendim “Për shqyrtim kërkesë të Institutit Demokratik Kombëtar dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit për akreditim vëzhguesish për zgjedhjet e 6 marsit”;

projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr. 87, datë 19.02.2022, për akreditimin e gazetarëve dhe operatorëve të Report TV”;

projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së BI Media, ABC, RTSH dhe Star Plus TV për akreditim vëzhguesish”;

projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së ambasadës holandeze, italiane, greke, çeke, austriake për akreditim vëzhguesish”;

dhe e fundit, projektvendim “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdoret në KZAZ-në 26, Bashkia Vorë”, ku do të zbatohet procesi i votimit elektronik.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 25.02.2022*

Z. Y. Merkaj: Nuk keni njoftuar për pikën e fundit.

Z. I. Celibashi: Nuk kemi njoftuar për këtë pikë? Mirë, këtë e shtyjmë për nesër, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, shkurtimisht referimi.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Elbasan ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, nga zonja Majlinda Sulejman Perriu, propozuar nga Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Elbasan, të cilit i kalon mandidati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 4, zonja Nadire Refat Çullhaj (Shkëmbi). Referuar nenit 11 të ligjit të dekriminalizimit dhe vetëdeklarimit, verifikimi i të dhënave, në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmërore për zgjedhjet pararendëse për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin e mbetur vakant. Kandidati për këshilltar ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, me numër unik 3. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr.138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar verifikimin ku rezulton se ka ndryshuar mbiemrin, ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, nga mbiemri Shkëmbi, në mbiemrin Çullhaj. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se nuk është e dënuar dhe nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, kreut të 5, të vendimit nr.17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 25.02.2022*

e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Elbasan, zonjës Nadire Refat Çullhaj nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e kandidatit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë meqenëse jemi në respektim të kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe të ligjit për dekriminalizimin vendosim që zonja Nadire Refat Çullhaj (Shkëmbi), kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.

Pika e dytë e këtij vendimi, plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Nadire Refat Çullhaj (Shkëmbi).

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 100

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



25.02.2022

Ora 17:45

RENDI I DITËS

*Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së Institutit Demokratik Kombëtar (NDI)
dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme
për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.*


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E. Allushi**
- **Parti Politike:** **S’ka**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 6 vëzhguesve afatgjatë, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gjithashtu, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 11 vëzhguesve afatgjatë dhe 27 vëzhguesve afatshkurtër. Kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga të dyja këto organizata plotësojnë kriteret ligjore për të caktuar vëzhgues. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 25.02.2022*

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë miratohet akreditimi si vëzhgues afatshkurtër i gjashtë të tillëve, nga NDI Albania dhe i 11 vëzhguesve afatgjatë dhe 27 vëzhguesve afatshkurtër të Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Vendim nr. 101

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



25.02.2022

Ora 17:46

RENDI I DITËS

Projektakti “Për një shtesë në vendimin nr. 87, datë 19.2.2022 “Për akreditimin e gazetarëve dhe operatorëve të Report TV, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z.Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y.Merkaj, M.Koja, E. Allushi

• **Parti Politike:**

S’ka


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës tjetër.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr.87, datë 19.02.2022 ka akredituar 45 vëzhgues, gazetarë dhe operatorë për Report TV. Gjithashtu televizioni Report TV ka paraqitur kërkesën për akreditimin edhe të 36 gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur plotëson kriteret ligjore për të caktuar vëzhgues. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord, atëherë miratohet edhe kërkesa e Report TV për akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme të 6 marsit, të 35 gazetarëve dhe operatorëve të këtij televizioni.

Vendim nr. 102

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



25.02.2022

Ora 17:47

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës së BI Media, ABC, RTSH dhe Star Plus TV, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y.Merkaj, M.Koja, E. Allushi

• **Parti Politike:**

S’ka

Z. I. Celibashi: Vazhohmë me pikën tjetër të rendit të ditës

Z. Y. Merkaj: BI Media ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 2 gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, gjithashtu televizioni ABC ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 24 gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. RTSH ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 82 gazetarëve dhe operatorëve, Star Plus TV ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 19 gazetarëve dhe operatorëve dhe kërkesat e paraqitura nga këto media plotësojnë kriteret ligjore për të caktuar vëzhgues dhe si do duhet të pranohen. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Këta i kanë sjellë jashtë afatit në fakt kërkesat për akreditim?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 25.02.2022*

Z. Y. Merkaç: Po, jashtë afatit, megjithatë është një afat prekluziv dhe mosrespektimi i tij nuk e humb të drejtën e tyre për të caktuar, ose për të kërkuar vëzhgues.

Z. I. Celibashi: Dakord! Mirë, prevalon interesi për transparencën e procesit, por në kushtet kur KQZ ka mundësi që ta konsiderojë këtë kërkesë jashtë afatit. Por, në rastet e tjera do duhet të komunikojmë për t'ua bërë të qartë, dhe duhet të jenë të parët për të respektuar këto afate.


Mirë, atëherë e miratojmë kërkesën për akreditimin e 2 vëzhguesve të BI Media, kërkesën për akreditimin e 24 gazetarëve dhe operatorëve të televizionit ABC.

Miratojmë kërkesën për akreditimin e 82 gazetarëve dhe operatorëve të Radio Televizionit Shqiptar.

Miratojmë kërkesën për akreditimin si vëzhgues të 19 gazetarëve dhe operatorëve të Star Plus TV.

Vendim nr. 103

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



25.02.2022

Ora 17:49

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e kërkesës të Ambasadës Hollandeze, Italiane, Greke, Çeke, Austriake për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E. Allushi**
- **Parti Politike:** **S’ka**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Ambasada e Holandës ka paraqitur kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 përkthyesve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gjithashtu, Ambasada e Italisë ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 5 vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 përkthyesve. Ambasada e Greqisë ka paraqitur kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për akreditimin e 2 vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 përkthyesve. Ambasada e Çekisë ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 2 vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 përkthyesve, si dhe në fund, Ambasada e Austrisë ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër dhe 6 përkthyesve. Kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga këto

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 25.02.2022*

ambasada është në përputhje me kriteret ligjore për të caktuar vëzhgues. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë: miratohet kërkesa e Ambasadës së Holandës për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 përkthyesve;

kërkesa e Ambasadës së Italisë për akreditimin e 5 vëzhguesve afatshkurtër dhe 4 përkthyesve;

kërkesa e Ambasadës së Greqisë për akreditimin e 2 vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 përkthyesve;

kërkesa e Ambasadës së Çekisë për të akredituar 2 vëzhgues afatshkurtër dhe 2 përkthyes;

kërkesa e Ambasadës së Austrisë për të akredituar 3 vëzhgues afatshkurtër dhe 6 përkthyes.

Seanca mbyllet! Natën e mirë!

Vendim nr. 104

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

